“Mos më kërko të dëshmoj, sepse unë nuk dëshmoj për padrejtësi”

Numan ibn Beshiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “Nëna ime, e bija e Revahës, i kërkoi babait tim të më dhurojë diç prej pasurisë së tij. Ai ia vonoi kërkesën për një vit, pastaj, kur atij iu mbush mendja, ajo i tha: “Nuk pranoj pa e bërë dëshmitar të Dërguarin e Allahut për dhuratën që po ia jep djalit.” Kështu, babai më mori për dore, ndërsa unë isha i ri e më çoi tek i Dërguari i Allahut dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, nëna e këtij, e bija e Revahës, ka dëshirë që ti të jesh dëshmitar për atë që ia kam dhuruar djalit.” - “O Beshir, a ke fëmijë të tjerë, përveç tij?” - pyeti i Dërguari i Allahut . - Po, - tha ai. - “A u ke dhënë të gjithëve sikurse këtij?” - pyeti i Dërguari i Allahut . - Jo, - tha ai. - “Mos më kërko të dëshmoj, sepse unë nuk dëshmoj për padrejtësi”, - i tha Pejgamberi .”

[Sahih] [متفق عليه، وله ألفاظ عديدة]

Numan ibn Beshiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!), tregoi se nëna e tij, Amra, e bija e Revahas (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i kërkoi babait të tij t’i jepte djalit të saj një dhuratë nga pasuria e tij. Ai hezitoi dhe e shtyu këtë për një vit, pastaj vendosi t'ia plotësonte kërkesën dhe t’i jepte dhuratë djalit të tij, Numanit. Atëherë ajo tha: "Nuk jam e kënaqur, derisa të dëshmojë i Dërguari i Allahut për atë që i dhurove djalit tim." Atëherë babai më mori për dore, ndërkohë që unë isha djalë i vogël, erdhi te i Dërguari i Allahut dhe tha: "O i Dërguari i Allahut, nëna e këtij (djalit), bija e Revahas, dëshiron që të të marrë dëshmitar për atë që i dhurova djalit të saj. Atëherë i Dërguari i Allahut tha:" "O Beshir, a ke fëmijë tjetër përveç këtij?" - Po, - tha ai. Ai tha: "A u ke dhuruar të gjithëve të njëjtën gjë si këtij?" - Jo, - tha ai. Profeti i tha: "Mos më kërko të dëshmoj, sepse unë nuk dëshmoj për padrejtësi.” Kurse në transmetimin e Muslimit, ai tha duke e qortuar: "Atëherë, merr dëshmitar tjetër përveç meje për këtë padrejtësi."

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/6035